

VENDIM
Nr.133, datë 9.12.2008

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.46, DATË 10.8.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E
VLERËS SË GJOBAVE DHE LLOGARITJES SË DËMIT QË DO TË APLIKOHEN
NDAJ KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 1 dhe 2 të ligjit nr.9997, datë 22.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Vendimi nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorim të energjisë elektrike”, i ndryshuar, për shkak të ndryshimit të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” sipas ligjit nr.9997, datë 22.9.2008, nuk plotëson më qëllimet e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorim të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. dhe KESH sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta